

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	30.10.2018
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: "QENDRIM GASHI" B.I.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.10.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "QENDRIM GASHI" B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve", me Nr. të Prok: 616 18 045 211 – për Lot-in 20 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "QENDRIM GASHI" B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve", me Nr. të Prok: 616 18 045 211, kundër Njoftimit për Vendim për dhënie të aktivitetit të AK -së, të datës 24.10.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vazhdon të mbetet në fuqi Njoftimi për Vendim për Dhënie të Kontratës i datës 24.10.2018 vetëm për Lot-in 20.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit me titull "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve", me Nr. 616-18-5283-2-1-1 Nr. Brendshëm 616 18 045 211 dhe mbështet aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 23.07.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: **“Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve”**, me Nr. 616-18-5283-2-1-1 Nr. Brendshëm 616 18 045 211.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 31.08.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Janë pranuar 18 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 24.10.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për Vendim për dhënie të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 25.10.2018, Operatorit Ekonomik “QENDRIM GASHI” B.L., iu ka lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik “QENDRIM GASHI” B.L., lidhur me aktivitetin e prokurimit : **“Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve”**, me Nr. 616-18-5283-2-1-1 Nr. Brendshëm 616 18 045 211, kundër Njoftimit për Vendim për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit të AK –së, të datës 24.10.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 28.10.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

1) *Pretendimi 1:* OE i rekomanduar për kontratë MINIBUS “NAIM GASHI” pas kërkesës tonë të parë për rishqyrtim ka sjellur një Konstatim të ri i lëshuar nga drejtori i shkollës Vehbi Gashi i lëshuar me datën 04.10.2018 me numër 101/2018 dhe i cili përmban një konstatim për kryerjen e transportit nga OE “NAIM GASHI” gjatë vitit 2015/2016 në shumë prej 10,360.00 € e cila nuk ka dëshmi për kontratat dhe asnjë transaksion financiar për kryerjen e këtij shërbimi dhe e tillë nuk mund të pranohet nga AK, pasi bie ndesh me ligjin dhe kriteret të cilat i ka përcaktuar vet AK. Konstatimit i tillë është i paligjshëm pasi që si ka mundësi OE i rekomanduar për kontratë “NAIM GASHI” të ketë kontrata për asgjë tjetër gjatë vitit 2015/2016 në vlerë 10,360.00 € kur vet biznesi “NAIM GASHI” është i inkorporuar me datën 29.08.2016 pranë Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve – pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

2) *Pretendimi 2:* Dëshmi tjetër se OE "NAIM GASHI" nuk ka kontratë të realizuar në shumën të cilën e ka sjellë drejtori i shkollës është edhe qarkullimi financiar dhe hapja e llogarisë pranë bankës Pro Credit Bank me datën 27.08.2015 dhe i tërë qarkullimi bankar deri me datën 27.08.2018 pra gjatë 3 viteve ka në total qarkullim prej 12,511.50 € dhe kjo e dëshmon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kushtet tek në **dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë**, respektivisht në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.2 që të ketë qarkullim 20,000.00 € për shërbime të ngjashme.

3) *Prentedimi 3:* OE i rekomanduar për kontratë e i cili është i papërgjegjshëm nuk ka bërë transportin e nxënësve gjatë vitit 2010/2016 Lagjja Myrtaj - Shkollë ashtu siç ka ofruar listën e kontratave pasi që OE i cili ka fituar kontratën për bartjen e këtyre nxënësve *Transporti i nxënësve për relacionet: Kroi i ftohtë - Hajkobillë e anasjelltas, Lagjja e Simojve - Shkolla amë Prapashticë e anasjelltas dhe Lagjja Bekaj - Shkolla amë "Isa Boletini" Busi dhe anasjelltas* në aktivitetin e shpallur nga Komuna e Prishtinës e cila përmban datën e njoftimit të kontratës 07.09.2011 me nr. prokurimi 616 11 169 211 dhe njoftimin për dhënie të kontratës me datën 07.09.2011 ku OE i rekomanduar për kontratë është "Hani Trans" Prishtinë dhe vlera e kontratës është 6,000.00 € dhe dëshminë për këtë e gjeni tek dokumentet e bashkëngjitura me këtë kërkesë për rishqyrtim dhe gjithashtu ky OE ka bërë transportin e nxënësve deri me datën 25.12.2018 përshkak të njoftimit mbi anulimin e procedurës së aktivitetit të prokurimit për transport.

4) *Pretendimi 4:* OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë transportin e nxënësve gjatë vitit 2015/2016 Lagjja Myrtaj - Shkollë ashtu siç ka thënë drejtori i shkollës në Busi në konstatimin e tij pasi që OE i cili ka fituar kontratën për bartjen e këtyre nxënësve Lagjja Myrtaj - Shkolla pjesa 6 në aktivitetin e shpallur nga Komuna e Prishtinës e cila përmban datën e njoftimit të kontratës 08.01.2016 me nr. prokurimi 616 16 002 221 dhe njoftimin për dhënie të kontratës me datën 19.02.2016 ku OE i rekomanduar për kontratë për këtë kontratë është "Loni G" - Prishtinë dhe vlera e kontratës 6,480.00 € dhe dëshminë për këtë e gjeni tek dokumentet e bashkëngjitura me këtë kërkesë për rishqyrtim.

5) *Pretendimi 5:* Në raportin e vlerësimit i datës 22.10.2018 anëtarë i komisionit për rivlerësimin e tenderëve është edhe Mentor Dragusha, i cili ka lëshuar dy referenca për OE "NAIM GASHI" i rekomanduar për kontratë, e të cilat njëra prej tyre nuk është valide pasi që referenca e lëshuar e datës 30.08.2018 për aktivitetin e prokurimit 616 17 136 211 me vlerë 7,955.00 € është e jashtëligjshme pasi kjo kontratë përfundon me datën

22.12.2018 dhe si e tillë ende nuk është realizuar as transporti e as pagesat për këtë aktivitet prokurimi dhe mbeten edhe dy muaj të plotë deri në realizimin e kontratës në tërësi. Me këtë rast në mendojmë se emërimi i Mentor Dragushës si anëtar i komisioni për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit është edhe konflikt interesi pasi që i njëjti është përmendur edhe në kërkesën e parë për rishqyrtim si zyrtar që ka bërë shkelje ligjore me rastin e lëshimit të referencave kundrejt mos përfundimit të shërbimeve ende.

6) *Pretendimi 6:* OE ka ofruar një listë të kontratave - projekteve të realizuara e cila nuk përmbush aspak kriterin e përcaktuar nga AK për këtë aktivitet prokurimi pasi që OE nuk e ka nënshkruar e as vulosur të njëjtën mirëpo vetëm ka shkruar një kontratë të vitit 2018 e cila nuk a përfunduar ende dhe vlera e saj është në çmim ditor 43.00 € si dhe një kontratë e vitit 2016 me vlerë çmimi ditor 35.00 € e cila bie ndesh me kërkesën e AK pasi që është kërkuar shuma e të gjithë kontratës. OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kushtin e përcaktuar nga vet AK për vlerën minimale prej 20,000.00 € andaj si i tillë duhet të shpallet i papërgjegjshëm. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një kontratë të nënshkruar nga vitit 2010 dhe e përfunduar nga viti 2016 e cila nuk mund të pranohet nga AK pasi që kushti i përcaktuar nga vet AK është për tri vitet e fundit dhe kontrata e vitit 2010 nuk pranohen si të tilla dhe nuk ka aspak dëshmi për realizimin e tyre pasi që vet biznesi me emër MINIBUS "NAIM GASHI" me nr. biznesi 70160112 dhe nr. fiskal 601677878 është i regjistruar dhe inkorporuar me datën 29.08.2016 dhe nr. fiskal është lëshuar me datën 08.09.2016.

7) *Pretendimi 7:* E gjetura tjetër në qasjen e dokumenteve zyrtare është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar tenderin në formë fizike si dhe ka bashkëngjitur 3 letër referenca të cilat 2 prej tyre janë të lëshuara me datën 30.08.2018 të cilat ngjallin dyshime se janë futur më vonë gjatë vlerësimit të tenderëve pasi që nuk përmbajnë nr. reference, d.m.th. nr. protokoli të cilat i aplikon gjithmonë Komuna e Prishtinës si dhe është bërë shkelje ligjore pasi që është lëshuar referenca nga menaxheri i projektit Mentor Dragusha për projektin "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve" me nr. të prokurimit 616 17 136 211 për OE i rekomanduar për kontratë e i cili është i papërgjegjshëm kur dihet se kontrata përfundon saktë me datën 22.12.2018 andaj duhet të merren masa ndaj këtij menaxheri të projektit nga e KK Prishtinë si dhe gjithashtu ne do të paraqesim rastin tek Kryetari i Komunës si dhe në Organet e Drejtësisë për rastin në fjalë.

8) *Pretendimi 8:* E gjetura tjetër në qasjen e dokumenteve zyrtare është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një referencë e cila është kërkuar nga z. Naim

Gashi dhe këtë referencë e ka lëshuar drejtori i shkollës "Isa Boletini" në Busi Vehbi Gashi me datën 30.08.2018, si dhe njëherit ka bërë shkelje të rëndë ligjore pasi që përmes kësaj reference ka bërë favorizimin e OE i rekomanduar për kontratë e i cili është i papërgjegjshëm duke thënë se ekziston mundësia e kësaj kompanie të i ipet kontrata pra MINIBUS "NAIM GASHI" pasi që kinse ka qenë shumë i afërt e gjëra të tilla të cilat përbëjnë shkelje ligjore dhe për këtë do ta paraqesim rastin tek Kryetari i Komunës KK Prishtinë si dhe Organet e Drejtësisë për rastin në fjalë.

9) *Pretendimi 9:* E gjetura tjetër në qasjen e dokumenteve zyrtare është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT me gabime dhe si i tillë është dashur të refuzohet nga AK pasi që ka ofruar çmimin për dy Lote, pra për Llot 17 dhe Llot 20 në të njëjtën formular pjesa C si dhe shihet mjaft mirë se çmimi nuk është i shkruar në shifra totale, mirëpo vetëm me shifra të çmimit ditor dhe si i tillë bie ndesh me rregullat mbi dorëzimin e tenderëve dhe si i tillë është dashur menjëherë të hedhet poshtë oferta e OE dhe nuk është dashur të merret në vlerësim. E gjetura tjetër është se OE i rekomanduar për Kontratë ka ofruar Lista të Çmimeve pra për Llot 20 dhe në të shkruan çmimi ditor është: cekim (55 euro) dhe si i tillë është dashur të refuzohet nga AK pasi që i njëjti nuk është çmim i cili duhet të ofrohet në Euro ashtu siç ceket në Dosjen e Tenderit dhe AK është dashur ta cilësoj si ofertë të papërgjegjshme automatikisht. Gjithashtu kemi parë se Minibus Naim Gashi ka dorëzuar Certifikatën e Gjykatës Kompetente për person fizik (pra për Naim Gashi) dhe jo për ndërmarrje ashtu siç ceket në kërkesat e pranueshmërisë.

10) *Pretendimi 10:* Me këtë vlerësim që është bërë nga AK ne si OE i përgjegjshëm jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform LPP pasi që në letrën standarde na është thënë:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse keni dorëzuar dy oferta njëtrën në mënyrë fizike e tjetrën në mënyrë elektronike:

27.5. OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet.

27.6 Nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet të prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurren si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzojë deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe rrjedhimisht të dy ofertat refuzohen - neni 27.6. të

Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik që tregojnë arsyeshëm se nuk keni plotësuar në mënyrë të rregullt përshkrimin e çmimit të saktësuar në dosjen e tenderit.

Ne mendojmë se kjo është e padrejtë pasi që OE kanë pasur të drejtë të fitojnë deri në 3 Lote çekim: *Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 3.*

Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se tre (3) Pjesë (Lote) atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për Pjesët (Lotet) që ofrojnë çmimin më të ulët të mundshëm për autoritetin kontraktues. Ne kemi konkuruar në njërin LOT, pra LOT 20 dhe atë në mënyrë elektronike që gjithqka të jetë e hapur dhe me këtë jemi diskriminuar dhe jemi trajtuar jo mirë pasi janë favorizuar OE të cilët nuk i përmbushin aspak kushtet për pjesëmarrje në këtë aktivitet prokurimi.

11) Pretendimi 11: Gjatë evaluimit të këtij aktiviteti të prokurimit, AK nuk ka bërë vlerësim të ofertuesve konform LPP dhe kushteve dhe kriterëve të vendosura nga vet AK.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, atëherë ne mendojmë që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim. AK ti trajtoj të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të barabartë dhe konform kriterëve të përcaktuara nga vet AK.

I. Baza ligjore për Refuzim të kërkesës.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

1) Pretendimit 1: OE ka ofruar listën e kontratave të realizuara si dhe referencat nga Drejtoria e Arsimit – Komuna e Prishtinës dhe nga Drejtori i shkollës amë "Isa Boletini" z. Vehbi Gashi për kryerjen e shërbimeve. Autoriteti Kontraktues bën shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave vetëm në bazë të dokumentacioneve të paraqitura dhe argumenteve, ndërsa paligjshmërinë e këtyre dokumentacioneve për manipulim apo falsifikim e konstatojnë organet e rendit dhe të drejtësisë. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur referencën e marrur nga Drejtori i shkollës në vlerë prej 10,360.00 € në periudhën kohore 2015/2016, me ç'rast ka përmbushur kriteret e kërkuara në pikën 9.1 dhe 9.2 të FTD-së.

2) Pretendimi 2: Sa i përket qarkullimit financiar lidhur me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar qarkullim financiar në kushtet për pjesëmarrje të paraqitura në FTD dhe Njoftim për Kontratë, andaj Autoriteti Kontraktues nuk lëshohet në shqyrtim të pikave të cilat nuk janë pjesë përbërëse të dosjes dhe aktivitetit në tërësi.

3) Pretendimi 3: Lidhur me transportin e nxënësve dhe arsimtarëve gjatë vitit 2010/2016 Operatori Ekonomik Minibus "Naim Gashi" në cilësinë e punëtorit në Hani Trans ka bërë transportin e nxënësve dhe arsimtarëve në aktivitetin me nr. 616 - 11 169 211 dhe pasi është bërë njoftimi për anulimin e aktivitetit OE Minibus "Naim Gashi" në cilësinë e personit juridik ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtarëve deri me datë 25.12.2015, me ç'rast edhe iu ka lëshuar referenca për tri vitet e fundit duke përfshirë edhe këtë vitin 2015.

4) Pretendimi 4: Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtarëve gjatë vitit 2015/2016 siç është cekur në mënyrë të dokumentuar me referencë zyrtare të lëshuar nga Autoriteti Shkolla Amë "Isa Boletini", me ç'rast Autoriteti Kontraktues vendos për vlerësim profesional vetëm në bazë të dokumentacioneve të lëshuara nga një Autoritet i cili nën kompetencat dhe përgjegjësitë e tij lëshon dokumentacion me efekt juridik, si në rastin konkret ku Drejtori i Shkollës amë "Isa Boletini" konstaton se OE Minibus "Naim Gashi" ka kryer shërbime për relacionin: "Lagjja Myrtaj - Shkollë" gjatë vitit 2015/2016. Ndërsa sa i përket dyshimeve të bazuara në kundërligjshmërinë e kësaj reference atëherë autoritetet për shqyrtimin e këtyre rasteve janë organet e rendit dhe të drejtësisë.

PROVË: Referenca e lëshuar nga Drejtori i Shkollës Amë "Isa Boletini" z. Vehbi Gashi

5) Pretendimi 5: Autoriteti Kontraktues respektivisht Drejtoria për Arsim ka caktuar 3 anëtar për ri-vlerësimin e ofertave, ku njëri prej anëtarëve është edhe Mentor Dragusha i cili fare nuk paraqet kundërligjshmëri e as Konflikt Interesi për shkak se është punonjës i komunës në Drejtorinë për Arsim dhe i cili në bazë të kërkesave të OE për shërbimet e kryera dhe gjatë kryerjes së shërbimeve në fazën finale lëshon referenca duke i vlerësuar shërbimet e kryerjes dhe atyre që janë në faze finale. Komisioni i Ri-vlerësimit ka bërë Ri-vlerësimin në mënyrë profesionale dhe gjatë ri-vlerësimit po ashtu është konstatuar nga anëtari i juaj i konsorciumit "DELI" shpk, se ju OE "QENDRIM GASHI" B.I. keni keqpërdorur në mënyrë të kundërligjshme dokumentacionin e tij saqë

deklaroi se do të bëjë kallëzim penal ndaj jush, andaj edhe pse këto deklarata janë dhënë në zyrë të Prokurimit ku dëshmitar janë edhe dy zyrtar të prokurimit të zyrës nr.56, Komisioni i Ri-vlerësimit prapë ka vazhduar në rivlerësimin e ofertës suaj dhe ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Pretendimi i juaj për Konflikt Interesi për njërin anëtar të komisionit të ri-vlerësimit fare nuk qëndron dhe është i pabazuar në mënyrë ligjore.

6) Pretendimi 6: Autoriteti Kontraktues ka pranuar vetëm referencat nga Autoriteti nën kompetencën e tij për lëshimin e referencave ku për bazë ka marrur referencat për vitet që janë paraqitur për vlerën 20,000.00 €, me ç'rast OE Minibus "Naim Gashi" ka përmbushur kriterin në fjalë ku vlerën e përgjithshme e ka 23,360.00 €.

7) Pretendimi 7: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës ka marrur për bazë vetëm referencat që janë dorëzuar nga Autoritetet me kompetencë për lëshimin e tyre për shërbimet që janë përfunduar dhe atyre që janë në fazën finale të përfunduar. Referencat që OE Minibus "Naim Gashi" janë referenca të lëshuara nga Autoriteti me juridiksion të plotë të kompetencës me çka përmbushin kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

8) Pretendimi 8: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës në bazë të referencës të lëshuar nga Autoriteti nën juridiksionin e plotë ligjor kompetent nga Drejtori i shkollës amë "Isa Boletini" ka pranuar referencën për kryerjen e shërbimeve nga Minibus "Naim Gashi". Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës nuk e ka kompetencën për shqyrtimin e favorizimeve të paligjshme ose kundër ligjore për lëshim të referencave pasi që për këtë merren organet e rendit dhe të drejtësisë. Autoriteti Kontraktues ka pranuar Referencën valide me të gjitha elementet juridike të saj dhe e ka konstatuar të vlefshme në bazë të kriterëve të përcaktuara në FTD.

9) Pretendimi 9: OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar formularin e tenderin me çmim ditor dhe me vlerë totale e cila është e cituar me fjalë (shkronjë për shkronjë) për të dy lotët andaj nuk kemi të bëjmë me asnjë shkelje ose gabim të plotësimit të formularit.

**Provë: Formulari i tenderit - pjesa C - MiniBus
"NAIM GASHI"**

Kurse sa i përket Certifikatën e Gjykatës Kompetente se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës MINIBUS "NAIM GASHI" ka dorëzuar për person fizik dhe jo për person juridik siç ceket në kërkesat e pranueshmërisë nuk qëndron pasi që AK po me datë: 26.09.2018, në ora: 09:20 am iu ka kërkuar të gjithë OE për rekomandim për dhënie të kontratës që ti sjellin Vërtetimin Tatimor dhe Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Administrative deri me datë 28.09.2018. Poashtu është e vërtetë që OE MINIBUS "NAIM GASHI" ka pasur certifikatën nga Gjykata themelore për person fizik mirëpo ka sjellur edhe Certifikatën nga Gjykata Themelore për person juridik dhe e ka sjellur.

Provë: Emaili i dërguar për OE i datës: 26.09.2018, ora: 09:20am.

10) Pretendimi 10: Lidhur me pretendim 5 dhe 6: AK ka vlerësuar të gjitha ofertat në bazë të Ligjit Për Prokurimin Publik, Udhëzuesit Operativ për Rregullat e Prokurimit Publik dhe kritereve të dosjes së tenderit. OE i eliminuar në konsorcium "QENDRIM GASHI" B.I. dhe N.T.P. "DELI" janë eliminuar sipas dorëzimit të ofertave të tyre për të njëjtin AKTIVITET (jo LLOT) edhe në mënyrë fizike dhe në mënyrë elektronike.

Baza ligjore:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse keni dorëzuar dy oferta një të njëjtin në mënyrë fizike e tjetrën në mënyrë elektronike:

27.5. OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet.

27.6 Nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet të prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurron si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzojë deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe rrjedhimisht të dy ofertat refuzohen - neni 27.6. të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik.

11) Pretendimi 11: Autoriteti Kontraktues vendos që të vazhdoj me dhënien e kontratës për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për LLOT 20 sipas Njoftimit për Vendimin për Dhënie të Kontratës bazuar në bazë të përmbushjes së kritereve të FTD-së, provave të prezantuara, dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

